





# LAJMET E RREME MBI PUSHTIMIN RUS TË UKRAINËS NË MEDIAT SHQIPFOLËSE





LAJMET E RREME MBI

**PUSHTIMIN RUS TË UKRAINËS**

NË MEDIAT SHQIPFOLËSE

Botuar nga: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri  
Rr. Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë, Shqipëri  
<http://birn.eu.com/>

Autorë: Kristina Voko  
Besar Likmeta

Përktheu: Durim Tabaku

Përkujdesja grafike: Jurgena Tahiri

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (Balkan Investigative Reporting Network in Albania - BIRN)  
Tiranë, 2023



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

Ky studim u financua nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Opinione, gjetjet, përfundimet apo rekomandimet e shprehura në të janë përgjegjësi tërësisht e Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmëri pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

# PËRMBAJTJA

## I. Konteksti 9

## II. Metodologjia 11

## III. Gjetjet 14

3.1 Përhapja e disinformimit në mediat shqipfolëse 14

3.2 Tendencat kryesore 18

3.3 Narrativat kryesore 21

3.4 Të rremet përkundër të vërtetave: Lufta kundër narrativave disinformuese 26

3.5 Angazhimi me lajmet e rreme 30

## IV. Përfundime dhe rekomandime 33

---



## Përkufizime operacionale:

BIRN Shqipëri ka hartuar dy raporte për disinformimin, lajmet e rreme dhe fotot dhe videot e shkëputura nga konteksti që lidhen pushtimin rus të Ukrainës gjatë periudhës janar-gusht 2022. Në këtë raport analizohet se si merren dhe raportohen në mediat dhe rrjetet sociale në gjuhën shqipe lajmet e rreme, të bazuara në falsifikime të qëllimshme, dhe imazhet dhe videot e nxjerra jashtë kontekstit, ndërsa raporti tjetër evidenton ndikimin e disinformimit shtetëror rus dhe përhapjen e tij në mediat standarde dhe ato sociale në gjuhën shqipe. Më poshtë janë renditur disa nga përkufizimet operacionale të termave kryesorë të përdorur për qëllimin e këtij raporti.

**Raportet për lajmet e rreme:** Këto i referohen raporteve të verifikimit të fakteve nëpërmjet bazës së të dhënave #UkraineFacts (fakte për Ukrainën), me të cilat përgënjeshtrohen artikujt me lajme të rreme nga pushtimi rus i Ukrainës.

**Artikuj me lajme të rreme:** Këta janë artikuj të botuara në media dhe që bazohen në fakte të falsifikuara qëllimisht.

**Narrativat e lajmeve të rreme:** I referohet narrativave apo tematikave më të përgjithshme, që përfshijnë artikuj të ndryshëm me “lajme të rreme”. Për shembull, artikujt me lajme të rreme mbi koston në jetë njerëzish të shkaktuar nga lufta, përhapja e teorive konspirative, lajme të rreme për shkaqet që çuan në përshkallëzimin ushtarak dhe përpjekjet për denigrimin çnjerëzor të armikut duke vlerësuar ose mohuar heroizmin e qëndresës ukrainase.

**Ripublikimet e lajmeve të rreme:** Këto janë ripublikime në mediat në gjuhën shqipe bazuar në artikujt origjinalë me lajme të rreme.

**Foto dhe video të nxjerra jashtë kontekstit:** Këto janë foto dhe video të vërteta që janë nxjerrë jashtë kontekstit. Ndonjëherë kjo do të thotë se ato janë zhvendosur nga një zonë lufte në tjetrën. Në raste të tjera, konteksti është shtrembëruar për t'iu përshtatur një narrative të caktuar. Për shembull, një foto e Miss Ukrainës e veshur me uniformë ushtarake u paraqit si provë se ajo i ishte bashkuar Ushtrisë Ukrainase në mbrojtje të atdheut, kur, në fakt, ajo nuk e kishte bërë një gjë të tillë.



## I. Konteksti

Më 24 shkurt 2022, pas shumë javë paralajmërimesh nga Perëndimi dhe mohimeve zyrtare nga Kremli, forcat ruse pushtuan Ukrainën, duke krijuar kështu skenën për një përshkallëzim të madh të luftës ruso-ukrainase, e cila filloi që në vitin 2014 me aneksimin nga Rusia të Gadishullit të Krimesë dhe që vazhdoi më pas me një luftë separatiste pro-ruse në Donbas, rajon në lindje të Ukrainës. Pushtimi ka shkakuar dhjetëra mijëra të vdekur dhe krizën më të madhe të refugjatëve në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Sipas Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, që nga 24 shkurti deri më 2 tetor 2022, në Ukrainë ka pasur 15,246 viktima mes civilëve: 6,114 të vrarë dhe 9,132 të plagosur.<sup>1</sup> Përshkallëzimi i konfliktit ka bërë që miliona njerëz të largohen nga Ukraina dhe shumë të tjerë të zhvendosen në zona të tjera brenda vendit. Sipas Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, UNHCR, deri më 25 tetor 2022, në të gjithë Evropën u regjistruan mbi 7.7 milionë refugjatë ukrainas.<sup>2</sup>

Nga ana tjetër, po vazhdon edhe një luftë informimi, e cila ka sjellë si rezultat një valë disinformimi që përhapet nëpërmjet kanaleve mediatike dhe platformave të mediave sociale. Kjo valë ka marrë forma të ndryshme, përfshirë këtu përpjekjet për të mohuar viktimat e sulmeve ushtarake ruse ndaj popullatës civile si dhe foto dhe video të nxjerra jashtë kontekstit të tyre origjinal ose nga konflikte të tjera dhe në disa raste edhe simulime nga video lojërat. Në një situatë krize si pushtimi i Ukrainës, disinformimi përhapet shpejt dhe shkon shumë larg, pavarësisht përpjekjeve të lëndueshme të mediave dhe organizatave që verifikojnë faktet për të përgënjeshtuar disinformimin dhe propagandën. Për të përcaktuar përhapjen e manipulimit të informacionit dhe disinformimit në

<sup>1</sup> KDNJ-OKB, "Ukrainë: përditësim i datës 3 tetor 2022 për viktimat civile", (2022), Url: <https://www.ohchr.org/en/news/2022/10/ukraine-civilian-casualty-update-3-october-2022>, Aksesuar më 26.10.2022.

<sup>2</sup> UNHCR, Situata me refugjatët ukrainas, (2022), <https://data.unhcr.org/en/situations/ukraine>, Aksesuar më 26.10.2022

Shqipëri, përmes platformave/kanaleve të ndryshme të komunikimit, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (BIRN) ndërmori një studim ku evidenton se sa përhapen dhe sa larg shkojnë në mediat në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe diasporën shqiptare, si dhe në kanale të njohura të mediave sociale si Facebook dhe YouTube, artikujt me lajme të rreme dhe fotot e videot e nxjerra jashtë kontekstit që lidhen me pushtimin rus të Ukrainës.

Nga ky hulumtim konstatohet se, ndryshe nga sa është raportuar më parë, në tetëmujorin e parë të vitit 2022 mediat në gjuhën shqipe në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut kanë përhapur lajme të rreme për Ukrainën. Këto lajme, që prodhohen kryesisht jashtë vendit dhe përhapen nëpërmjet platformave të mediave sociale, janë përkthyer dhe ripublikuar në shqip nga mediat lokale. Në këto media bëjnë pjesë faqet e internetit të mediave digjitale në vend, televizionet, radiot dhe gazetatat, si dhe kanalet e tyre të mediave sociale, kryesisht për arsye komerciale. Bazuar në numrin e ripublikimeve të lajmeve të rreme që janë shfaqur në mediat shqipfolëse dhe në krahasim me rastet e raportuara në vende të tjera të rajonit dhe në botë, hulumtuesit kanë arritur në përfundimin se përhapja e informacioneve të rreme për konfliktin ka qenë më e lartë nga sa është raportuar më parë. Edhe pse të përhapura fillimisht në platforma të ndryshme të mediave sociale, hulumtuesit konstatuan se pjesa më e madhe e lajmeve të rreme për pushtimin e Ukrainës nga Rusia u përkthyen dhe u ripublikuan në shqip nga mediat kryesore – qofshin këto media digjitale, televizione apo shtypi i shkruar. Mediat digjitale, të cilat në vend njihen shpesh si portale lajmesh, priren të kenë një numër më të madh të ripublikimeve të lajmeve të rreme në krahasim me mediat standarde - kanalet televizive ose shtypin e shkruar.

Mediat shqiptare kanë në përgjithësi struktura të dobëta editoriale ndërkohë që strukturat editoriale në mediat e sapokrijuara digjitale janë pothuajse inekzistente, gjë që shpjegon sasinë e madhe të lajmeve të rreme që përkthehen dhe ripublikohen në to.

## II. Metodologjia

Deri më sot, janë publikuar pak prova për përpjekje konkrete dhe të vazhdueshme nga një fuqi apo qeveri e huaj për të ndërhyrë në politikën dhe çështjet ndërkombëtare të Shqipërisë nëpërmjet fushatave disinformuese apo të ndikimit, bazuar në publikimin e artikujve me lajme të rreme dhe videove apo fotove të nxjerra jashtë kontekstit. Megjithatë, kur bëhet fjalë për ngjarjet kryesore të lajmeve ndërkombëtare, të tilla si “lufta e (dis)informimit” e nxitur nga mediat sociale në lidhje me pushtimin rus të Ukrainës<sup>3</sup>, lajmet e rreme nuk është e thënë të synojnë një vend të caktuar për të ndikuar narrativat dhe ndryshuar perceptimet. Mediat shqiptare dhe konsumatorët e lajmeve dhe informacioneve në vend nuk janë të imunizuar ndaj disinformimeve për pushtimin rus të Ukrainës që përhapen në formën e lajmeve të rreme, fotove dhe videove të modifikuara ose të nxjerra jashtë kontekstit, të transmetuara përmes rrjeteve online, televizioneve e radiove dhe mediave sociale.

Për të hulumtuar përhapjen në mediat lokale të lajmeve të rreme, fotove dhe videove mbi pushtimin rus, BIRN Shqipëri përdori një bazë të dhënash të artikujve të rremë të quajtur ‘#UkraineFacts’ (fakte për Ukrainën)<sup>4</sup>, krijuar nga organizata spanjolle e verifikimit të fakteve ‘Maldita.es’, ku përfshihen informacione dhe kontribute nga më shumë se 100 verifikues faktesh në mbarë botën, nënshkrues të kodit të Rrjetit Ndërkombëtar të Verifikimit të Fakteve (IFCN). IFCN është një rrjet ndërkombëtar i verifikuesve të fakteve i krijuar në vitin 2015 nga Instituti Poynter me qendër në SHBA, me më shumë se 100 organizata në mbarë botën. Ky rrjet promovon informacionin e bazuar në fakte dhe punon për të ndryshuar rrjedhën në luftën globale kundër keqinformimit.<sup>5</sup>

<sup>3</sup> Verfassungsblog, “Lufta në Ukrainë, lajmet e rreme dhe ndarja epistemike digjitale”, (2022), <https://verfassungsblog.de/the-war-in-ukraine-fake-news-and-the-digital-epistemic-divide/>, Aksesuar më 26.10.2022.

<sup>4</sup> Maldita.es, “Baza e të dhënave #UkraineFacts”, (2022), <https://ukrainefacts.org/>, Aksesuar më 31.10.2022.

<sup>5</sup> Instituti Poynter, “Çfarë është Rrjeti Ndërkombëtar i Verifikimit të Fakteve?”, (2021), <https://www.poynter.org/ifcn/>, Aksesuar më 27.10.2022.

Në bazën e të dhënave '#UkraineFacts' u mbledhën gjithsej 2,425 raporte verifikimi faktesh të publikuara në vende të ndryshme për 318 lajme të ndryshme të rreme ose video dhe foto të nxjerra jashtë kontekstit që u botuan për pushtimin rus të Ukrainës, duke filluar nga janari 2022 deri në fund të gushtit 2022. Mesatarisht një artikull me lajme të rreme u përgënjeshtrova tetë herë nga organizata të ndryshme verifikuese të fakteve, shpesh në vende dhe gjuhë të ndryshme, pasi artikulli kishte bërë xhiron në rrjetet sociale. Për çdo artikull me lajme të rreme të përgënjeshtruar, u identifikuan fjalët kyçe, termat dhe fraza e kërkimit në internet, u përdorën teknika të përkthyer dhe të kërkimit të hapur, për të kërkuar ripublikime në mediat në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Edhe pse qëllimi kryesor i hulumtimit ishte identifikimi dhe përshkrimi i përhapjes së lajmeve të rreme, veçanërisht në Shqipëri, mediat shqipfolëse nga rajoni, diaspora apo mediat ndërkombëtare me shërbime në gjuhën shqipe kanë edhe ato lexues e dëgjues në Shqipëri, kështu që u mbledhën të dhëna edhe nga këto burime. Të dhënat e mbledhura nga hulumtimi u hodhën në një fletë pune në Excel si dhe u analizuan përmes tabelave Pivot.

Ndonëse lista e artikujve me lajme të rreme të identifikuar në bazën e të dhënave #Ukrainefacts nuk është shteruese dhe nuk përfshin të gjithë artikujt, postimet apo fotot dhe videot e nxjerra jashtë kontekstit me lajme të rreme që kanë qarkulluar në lidhje me pushtimin rus të Ukrainës gjatë vitit të kaluar, ajo është baza më e madhe e të dhënave e llojit të saj që u identifikua nga hulumtuesit. Kjo bazë të dhënash u përzgjodh edhe për faktin se ajo e trajton përhapjen në nivel botëror të disinformimeve për konfliktin, duke përdorur kontributin e dhjetëra organizatave që verifikojnë faktet dhe nuk fokusohet vetëm në një vend apo rajon të caktuar ose te një organizatë e veçantë fakt-verifikuese me shtrirje të gjerë gjeografike.

Fushatat disinformuese nuk janë të panjohura në botën e luftës asimetrike; gjithsesi, me ardhjen e platformave teknologjike dhe rritjen e rolit të tyre në përhapjen e informacionit, lajmet e rreme mund të shkojnë edhe më larg, me shpejtësi, sasi dhe distanca që ishin të pamundura në të shkuarën.

Lajmet e rreme mund të kenë motive ideologjike, por edhe komerciale. Ato bëjnë fjalë për lajme që

botohen me qëllim që t'i bërë njerëzit të besojnë diçka të pavërtetë, ose për të fituar klikime dhe të ardhura të mundshme në një faqe të caktuar interneti. Lajme të tilla janë gënjeshtër të qëllimshme, që do të thotë se personi ose subjekti që i publikon ato është i vetëdijshëm se këto lajme janë të sajara. Ndonëse lajme të tilla mund të kenë në përmbajtje disa të vërteta, ato janë të pasakta dhe nxjerrin fakte që mund të jenë versione të ekzagjeruara ose të keqinterpretuara të realitetit.<sup>6</sup>

Për të matur dhe për të kuptuar më mirë angazhimin e lexuesve dhe përdoruesve të mediave sociale me artikujt me lajme të rreme për pushtimin rus të Ukrainës të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe dhe përgënjeshttrimin e këtyre lajmeve të rreme nga organizatat fakt-verifikuese, BIRN Shqipëri përdori Crowdangle për matur nivelin e angazhimit të tyre në Facebook dhe shikimet e videove. CrowdAngle është një instrument analize opinioni publik nga Meta që i vjen në ndihmë botuesve, gazetarëve, studiuesve, verifikuesve të fakteve dhe aktorëve të tjerë për të ndjekur, analizuar dhe raportuar për atë që po ndodh në mediat sociale. CrowdAngle gjurmon ndërveprimet, të cilat përkufizohen si reagime, komente dhe shpërndarje. Edhe ndërveprimet njihen si angazhim.<sup>7</sup>

Hulumtuesit përdorën produktin 'Kërkimi CrowdAngle' për të gjetur dhe zbuluar përmbajtje në mediat sociale, duke kërkuar me anë të fjalëve kyçe të përkthyer të artikujve me lajme të rreme të listuara në bazën e të dhënave #UkraineFacts për të gjetur ripublikime të tyre në mediat në gjuhën shqipe. Për shikimet e videove në YouTube, hulumtuesit përdorën përshkrimin e vënë në dispozicion për secilën video për të identifikuar lajmet e rreme. Të dhënat për ndërveprimet dhe shikimet e videove u mblodhën gjatë periudhës së hulumtimit, gusht-tetor 2022, dhe iu nënshtroan ndryshimeve të vogla (për ato që u ripanë), sepse për postimet, fotot dhe videot në mediat sociale me kalimin e kohës zakonisht regjistrohen ndërveprime të reja. Gjithsesi, pjesa dërrmuese e ndërveprimeve regjistrohet në postimet e mediave sociale në 48 orët e para pas publikimit, përveç rasteve kur

---

<sup>6</sup> BBC, "Çfarë janë lajmet e rreme? Dhe si t'i dallojmë ato?", (2019), <https://www.bbc.co.uk/newsround/38906931>, Aksesuar më 27.10.2022.

<sup>7</sup> Crowdangle, "Të kuptojmë dhe citojmë të dhënat e CrowdAngle", (2022), <https://help.crowdtangle.com/en/articles/4558716-understanding-and-citing-crowdtangle-data>, Aksesuar më 6.11.2022.

një postim ndahet sërish më vonë nga një faqe e njohur ose nga një llogari me një numër të lartë ndjekësish.

### III. Gjetjet

Nëpërmjet të dhënave të mbledhura, hulumtuesit kishin mundësinë të përcaktonin shkallën e përhapjes së lajmeve të rreme që kanë qarkulluar në tetë muajt e parë të vitit 2022 në mediat në gjuhën shqipe për agresionin rus ndaj Ukrainës. Hulumtuesit arritën në përfundimin se, ndryshe nga perceptimi që mbizotëron, mediat shqipfolëse nuk janë immune ndaj disinformimit rus dhe publikimit të lajmeve të rreme për pushtimin e Ukrainës. Numri i lajmeve të rreme që qarkullojnë në mediat shqiptare për pushtimin e Ukrainës nga Rusia është i krahasueshëm me vendet e tjera të rajonit, si Serbia apo Bosnja dhe Hercegovina, të cilat janë evidentuar më parë si objektiva të fushatave ruse të disinformimit. Lajmet e rreme për pushtimin rus të Ukrainës që qarkullojnë në mediat në gjuhën shqipe kanë mesazhe si pro-ruse ashtu edhe pro-ukrainase. Po ashtu, hulumtuesit ishin në gjendje të identifikonin lajme që përgënjeshtrojnë lajmet e rreme apo foto dhe video të nxjerra nga konteksti të publikuara nga mediat dhe shërbimet e verifikimit të fakteve për pushtimin rus të Ukrainës. Megjithatë, niveli i ndërveprimit me lajmet e rreme në mediat sociale është shumë më i lartë se niveli i ndërveprimit me lajmet që i përgënjeshtrojnë ato.


#### 3.1 Përhapja e disinformimit në mediat në gjuhën shqipe

Nëpërmjet hulumtimit u arrit të identifikoheshin 41 artikuj me lajme të rreme, video ose foto të nxjerra jashtë kontekstit të publikuara në mediat lokale ose mediat sociale në periudhën shkurti-gusht 2022. Këta artikuj me lajme të rreme regjistruan në total 793 ripublikime në mediat vendase apo në faqet e mediave sociale. Për pjesën më të madhe të rasteve të disinformimit u regjistruan ripublikime të shumta në mediat lokale në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut - deri në 59 herë për një lajm të vetëm.

BIRN Shqipëri ishte në gjendje të identifikonte 35 përgënjeshtime të artikujve me lajme të rreme nga mediat lokale apo organizatat fakt-verifikuese në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, me një total prej 138 ripublikimesh.

**Figura 1. Numri i ripublikimeve të regjistruara në mediat në gjuhën shqipe**

NUMRI I RIPUBLIKIMEVE TË REGJISTRUARA NË MEDIAT NË GJUHËN SHQIPE




Artikujt me lajme të rreme janë ripublikuar gjithsej nga 390 media, në faqet e tyre të internetit apo

në platformat e mediave sociale. Më shumë se gjysma e tyre (52.3 për qind) qarkulluan në mediat me qendër në Shqipëri, 36.9 për qind nga mediat me qendër në Kosovë dhe 10.8 për qind në Maqedoninë e Veriut.

Pjesa më e madhe e 390 mediave në gjuhën shqipe (58.5 për qind) kanë publikuar vetëm një lajm të rremë nga lista e artikujve të monitoruar me lajme të rreme, ndërsa 36.4 për qind kanë publikuar nga dy deri në pesë artikuj me lajme të rreme dhe 4.4 për qind të publikuara ndërmjet gjashtë deri në dhjetë artikuj me lajme të rreme gjatë tetë muajve të parë të vitit 2022. Vetëm tre media kanë ripublikuar më shumë lajme të rreme, përkatësisht me 12, 13 dhe 15 artikuj.

## Figura 2. Numri i mediave që kanë publikuar artikuj me lajme të rreme

NUMRI I MEDIAVE QË KANË PUBLIKUAR ARTIKUJ ME LAJME TË RREME






Të dhënat sugjerojnë mjaft qartë se mediat digjitale online në vend, shpesh të njohura edhe si portale lajmesh, janë më të prirura se çdo lloj tjetër medie të publikojnë lajme të rreme për pushtimin rus të Ukrainës. Vitet e fundit në Shqipëri janë krijuar me qindra media të tilla. Nga 793 ripublikime të 41 artikujve me lajme të rreme të identifikuara në mediat në gjuhën shqipe për periudhën janar-gusht 2022 për pushtimin rus të Ukrainës, 72.6 për qind u publikuan online nga portalet, 10.5 për qind nga stacionet televizive dhe pjesa tjetër nga faqet publike në Facebook ose kanalet në YouTube, gazetatat, radiot dhe faqet e revistave në internet.

Nga 793 referenca për lajme të rreme për pushtimin rus të Ukrainës, 73.8 për qind u ripublikuan si lajme me foto dhe video në lloje të ndryshme mediash, 3.8 për qind e artikujve ishin video të publikuara në kanale të mediave të ndryshme sociale dhe 17.6 për qind e artikujve u ripublikuan si foto në Facebook.

### Figura 3. Numri i ripublikimeve të lajmeve të rreme sipas formatit




## 3.2 Tendencat kryesore

Sipas të dhënave të mbledhura nga baza e të dhënave #UkraineFacts, pjesa më e madhe e rasteve të disinformimeve që u ripublikuan në mediat në gjuhën shqipe për pushtimin rus të Ukrainës e kishin origjinën ose u publikuan fillimisht në kanalet e mediave sociale. Më shumë se 85 për qind e lajmeve të rreme të identifikuara nga ky monitorim, veçanërisht ato të bazuara në foto dhe video të fabrikuara ose të nxjerra jashtë kontekstit, e kanë origjinën nga kanalet e mediave sociale, përfshirë këtu Facebook, Twitter dhe Instagram. Burime të tjera ishin edhe tabloidët si Daily Mail, New York Post, Fox News, Daily Mirror ose media në pronësi të shtetit rus si Sputnik. Zakonisht, këto artikuj me lajme të rreme përktheheshin nga një media lokale dhe më pas ripublikohen nga shumë të tjera.

**Figura 4. Përqindja e narrativave pro-ukrainase dhe pro-ruse në lajmet e rreme**

PËRQINDJA E NARRATIVAVE PRO-UKRAINASE DHE PRO-RUSE NË LAJMET E RREME



Pjesa më e madhe (61 për qind) e ripublikimeve të lajmeve të rreme që qarkullonin në mediat në gjuhën shqipe dhe në kanalet e mediave sociale në lidhje me pushtimin e Ukrainës kishin mesazhe pro-ukrainase dhe 39 për qind përçonin mesazhe pro-ruse.

Të dhënat e mbledhura dhe analizuar nga aplikacioni Crowdtangle në pronësi të Facebook tregojnë se ripublikimi i lajmeve të rreme në gjuhën shqipe me mesazhe pro-ukrainase kishin një shkallë më të lartë ndërveprimi/angazhimi në mediat sociale krahasuar me ato me mesazhe pro-ruse.

Në total, për ripublikimet e lajmeve të rreme me mesazhe pro-ukrainase u regjistruan 182,731 ndërveprime dhe 913,437 shikime video në Facebook si dhe 96,461 shikime video në YouTube, ndërsa nga lajmet me mesazhe pro-ruse u regjistruan vetëm 7,653 ndërveprime dhe 192,725 shikime të videove në Facebook. Këto të dhëna sugjerojnë se publiku shqiptar është shumë më i hapur ndaj narrativave pro-ukrainase lidhur me konfliktin.

## **RAST STUDIMOR: Video dhe foto të nxjerra jashtë kontekstit me mesazhe pro Ukrainës**

Më 25 shkurt, në Facebook dhe Twitter, u publikua një video ku tregohej një burrë i veshur me rroba kamuflazhi dhe kapuç të zi që i jepte lamtumirën një gruaje. Videoja u shoqërua me postimin: “Ushtarët ukrainas lënë gratë e tyre për të shkuar në një luftë si kjo. Të lutem kthehu shpejt. 🇺🇦 #Ukraine #Russia #Ucrania.”<sup>8</sup> Një ditë më vonë, një imazh nga kjo video u përdor në një insert të emisionit televiziv ‘Shqipëria Live’ në TV Top Channel me foto emocionale të ushtarëve ukrainas që shkonin në luftë.<sup>9</sup> Gazetarja në

<sup>8</sup> Twitter, @techz\_dave, 25 shkurt 2022, ora 01:06, Ushtarët ukrainas lënë gratë e tyre për të shkuar në luftë, [https://twitter.com/techz\\_dave/status/1496999930828713989](https://twitter.com/techz_dave/status/1496999930828713989), Aksesuar më 11.01.2022.

<sup>9</sup> Top Channel TV, Shqipëria Live, 25 shkurt 2022, <https://www.youtube.com/watch?v=b1HbpkFDZtU>, Aksesuar më 11.01.2022.

studio komentonte foton duke nënvizuar se ushtarët po u jepnin lamtumirën familjeve të tyre teksa niseshin për në vijën e parë të frontit. Hulumtimet nga organizata të ndryshme të verifikimit të fakteve kanë zbuluar se videoja nuk është reale, por skenar dhe pjesë e një filmi të quajtur “Lufta e Kimerës”. Nuk ka të dhëna për shikueshmërinë e këtij emisioni, por në YouTube kjo video ka marrë mbi 15,004 shikime që nga data 2 nëntor 2022. Videoja e ushtarit ukrainas duke i dhënë lamtumirën gruas së tij është përgënjeshtuar si lajm i rremë nga dy portale në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, përkatësisht Lapsi.al dhe Portalb.mk, si dhe nga organizata me qendër në Tiranë Faktoje.al. Ndonëse nuk ka të dhëna për numrin e lexuesve të lajmeve të rreme të përgënjeshtuara, për këto përgënjeshtime u regjistruan vetëm disa komente në mediat sociale.



Inserti përmbante dy foto të tjera mjaft të përhapura, por të nxjerra jashtë kontekstit. Njëra foto portretizonte Kryetarin e Bashkisë së Kievit, Vitali Klitschko, me një mitraloz dhe veshje ushtarake dhe fotografia tjetër është ajo e një çifti të veshur me flamujt rus dhe ukrainas, ku theksohej dëshira e civilëve për paqe. Edhe këto dy foto janë nxjerrë jashtë kontekstit dhe nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta me pushtimin rus të Ukrainës në shkurt 2022. Fotoja e Klitschkos është shkrepur në vitin 2021, kur ai mernte pjesë në një manovër ushtarake në terren me rezervistë.<sup>10</sup> Edhe fotoja e çiftit të veshur me flamurin rus dhe ukrainas është e vjetër. Ajo është publikuar për herë të parë në vitin

<sup>10</sup> Portali ‘Logically.’: “Kryetari i Bashkisë së Kievit, Vitali Klitschko, fotografohet me uniformë ushtarake me një mitraloz teksa lufton për Ukrainën”, (2022), <https://www.logically.ai/factchecks/library/489838e5>, Aksesuar më 11.02.2022.

2019 në një artikull të Washington Post nga Isabelle Khurshudyan.<sup>11</sup>

Përveç insertit të emisionit “Shqipëria Live”, që u transmetua në televizionin kombëtar Top Channel më 26 shkurt 2022, fotografia e nxjerrë jashtë kontekstit e Klitschkos u ripublikua nga të paktën 16 media të tjera në gjuhën shqipe. Edhe fotoja e vjetër e çiftit, e veshur me flamuj rus dhe ukrainas, regjistroi 16 ripublikime në media të ndryshme dhe rrjete sociale në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri. Fotoja qarkulloi kryesisht në Kosovë dhe u vërtetua si e pavërtetë nga organizata e verifikimit të fakteve Kallxo.com. Sipas të dhënave të Crowdtangle, artikulli me lajmin e rremë me foton e vjetër të çiftit të mbështjellë me flamuj mori gjithsej 11,212 reagime në Facebook. Ndërkohë, përgënjeshtrimi i lajmit të rremë mori gjithsej 70 komente, ose më pak se një për qind e reagimeve që iu bënë postimit me lajmin e rremë. Këto të dhëna sugjerojnë se, pavarësisht përpjekjeve më të mira të bëra nga organizatat e verifikimit të fakteve për të demaskuar mashtrimet, artikujt me lajme të rreme kanë potencialin të përhapen më shumë dhe më shpejtësi më të madhe në mjedisin e mediave online.

### 3.3 Narrativat kryesore

Edhe pse konflikti në Ukrainë vazhdon ende i përgjakshëm, nga hulumtimet e mëparshme dhe monitorimi i tendencave të disinformimeve të bazuara në lajme me verifikim faktesh të publikuara nga rrjete të tilla si #UkraineFacts janë identifikuar një sërë narrativash që përdoren për të përhapur mesazhe pro-ukrainase dhe pro-ruse.<sup>12</sup> Këto narrativa ishin të përsëritura te lajmet e rreme dhe

<sup>11</sup> Washington Post, “Ajo mbante flamurin rus. Ai kishte atë të Ukrainës. Disa njerëzve u pëlqeu fotografia por disa të tjerë ishin të tronditur nga kjo foto.”, (2019), [https://www.washingtonpost.com/world/europe/she-wore-the-russian-flag-he-had-ukraines-some-people-loved-the-photo-and-others-were-aghast/2019/12/04/a5f32ba0-15df-11ea-80d6-d0ca7007273f\\_story.html](https://www.washingtonpost.com/world/europe/she-wore-the-russian-flag-he-had-ukraines-some-people-loved-the-photo-and-others-were-aghast/2019/12/04/a5f32ba0-15df-11ea-80d6-d0ca7007273f_story.html), Aksesuar më 11.01.2022.

<sup>12</sup> Disinfo.eu, “Disinformimi për konfliktin në Ukrainë: narrativat dhe tendencat në botë” (2022), <https://www.disinfo.eu/publications/ukraine-conflict-disinformation-worldwide-narratives-and-trends/>, Aksesuar më 11.05.2022.

fotot dhe videot e marra jashtë kontekstit dhe të ripublikuara edhe në mediat në gjuhën shqipe. Kategoritë kryesore të tyre janë si më poshtë:


- Përshkallëzimi ushtarak
- Denigrimi çnjerëzor i armikut/vlerësimi me merita i ushtarëve
- Teoritë konspirative
- Kostot e luftës në jetë njerëzish

Kategoria më e madhe për sa i përket numrit të ripublikimeve së lajmeve të rreme të regjistruara ishte “Kostoja e luftës në jetë njerëzish” (me 29 për qind), e ndjekur me po të njëjtën përqindje nga “përshkallëzimi ushtarak” (29 për qind), më pas nga “Denigrimi i armikut/vlerësimi me merita i ushtarëve” (me 25 për qind) dhe, e fundit, “teoritë konspirative” (me 17 për qind).

Po ashtu, kategoria “Kostoja e luftës në jetë njerëzish” kishte numrin më të madh të ndërveprimeve të regjistruara për lajmet e rreme në Facebook, e barabartë me 64 për qind të totalit, e ndjekur nga “Denigrimi çnjerëzor i armikut/vlerësimi me merita i ushtarëve” (26 për qind) dhe “përshkallëzimi ushtarak” (9 për qind). Lajmi pozitiv nga këto të dhëna është se narrativa lidhur me “teoritë konspirative” regjistroi vetëm një për qind të ndërveprimeve në total.

**Figura 5. Numri i ndërveprimeve për narrativat kryesore të identifikuara**

**NUMRI I NDËRVEPRIMEVE PËR NARRATIVAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA**



Në narrativën e “përshkallëzimit ushtarak” bënë pjesë histori ku raportoheshin detaje të gabuara të operacioneve ushtarake dhe për reagimin ndërkombëtar ndaj pushtimit dhe ku nxirreshin jashtë kontekstit foto dhe video. Narrativa e “kostos së luftës në jetë njerëzish” lidhet kryesisht me foto dhe video të nxjerra jashtë kontekstit të ushtarëve ukrainas që u jepnin lamtumirën familjarëve të tyre teksa niseshin për në vijën e parë të frontit, por edhe foto të refugjatëve dhe të njerëzve të famshëm të veshur me uniforma ushtarake. Narrativa “Denigrimi çnjerëzor i armikut/vlerësimi me merita

i ushtarëve” përmbante propagandë që synonte të vlerësonte heroizmin e qëndresës ukrainase, si historia e fabrikuar për Fantazmën e Kievit,<sup>13</sup> ose pretendimet në favor ose kundër Presidentit ukrainas Volodomyr Zelensky. Fantazma e Kievit është pseudonimi që i është dhënë një asi mitik fluturues i avionëve MiG-29, i njohur për rrëzimin e gjashtë avionëve rusë mbi Kiev gjatë ofensivës së Kievit në shkurt 2022. Ndërkohë, narrativa e teorive konspirative kishte të bënte me lajme të rreme për laboratorë të armëve biologjike në Ukrainë të financuara nga SHBA-ja dhe një nën-narrativë ose mohime për një sulm rus kundër civilëve në qytetin e Mariupolit.

Për shembull, më 9 mars 2022, avionët luftarakë rusë bombarduan një spital në qytetin ukrainas të Mariupolit, duke vrarë tre persona dhe duke plagosur 17 të tjerë, përfshirë këtu dy gra shtatzëna. Fotot e grave të plagosura u shpërndanë nga mediat në të gjithë botën. Postimet e rreme në rrjetet sociale, disa prej të cilave u ripublikuan nga mediat në gjuhën shqipe, pretendonin se një nga shtatzënat e plagosura ishte aktore.

## **RAST STUDIMOR: Teoritë konspirative me mesazhe pro-ruse**

Akuzat e rreme dhe informacionet mashtruese janë elementë që u përdorën për të justifikuar pushtimin rus të Ukrainës, duke filluar që nga shpallja e luftës nga Vladimir Putin më 21 shkurt 2022, e cila përmbante shumë pretendime të dyshimta historike.<sup>14</sup>

Gjashtë nga shtatë lajmet e rreme që u identifikuan nga hulumtuesit sipas narrativës së teorive konspirative kishin mesazhe pro-ruse dhe gjysma e tyre lidheshin me temën e pavërtetë të pranisë së pretenduar të

<sup>13</sup> Balkanweb.com, “Kush është “fantazma e Kievit”? Historia e pilotit ukrainas bëhet virale, rrëzon gjashtë aeroplanë rusë,” (2022), Url: <https://www.balkanweb.com/kush-eshte-fantazma-e-kievit-historia-e-pilotit-ukrainas-behet-virale-rrazon-gjashte-aeroplan-ruse/>, Aksesuar më 11.01.2022.

<sup>14</sup> Washington Post, “Verifikimi i fakteve të fjalimit të Putinit për Ukrainën”, (2022), <https://www.washingtonpost.com/politics/2022/02/23/fact-checking-putins-speech-ukraine/>, Aksesuar më 19.12.2022



laboratorëve të armëve biologjike në Ukrainë të financuara nga SHBA-ja, të cilat synonin të justifikoni pushtimin rus të nisur nga Putini në shkurt, duke e përshkruar Kievin si një kërcënim për Federatën Ruse. Hulumtuesit arritën të identifikonin tre lajme të rreme me të njëjtën temë, të cilat qarkulluan në mediat shqifolëse. Më i përhapuri ishte një artikull i lajmeve të rreme që pretendonte se Hunter Biden, djali i Presidentit amerikan Joe Biden, kishte ngritur një sërë laboratorësh armësh biologjike në Ukrainë. Pretendimi bazohej në një deklaratë të bërë më 24 mars 2022 në një konferencë të shkurtër shtypi nga Igor Kirilov, komandanti i Forcave të Mbrojtjes Atomike, Biologjike dhe Kimike të Ushtrisë Ruse, dhe një histori e publikuar më 25 mars 2022 nga tabloidi britanik Daily Mail<sup>15</sup>, ku pretendohet se Hunter Biden kishte ndihmuar për sigurimin e miliona dollarëve fonde për një kontraktor amerikan në Ukrainë i specializuar për kërkimin e patogjenëve vdekjeprurës. Në një tjetër lajm, të publikuar nga media ruse First Channel, pretendohet se kompania amerikane “Metabiota” ishte shfaqur në Ukrainë me ndihmën e Hunter Biden. Variante të kësaj historie janë zbuluar edhe nga verifikuesit e fakteve në mediat standarde dhe mediat sociale në Gjeorgji dhe Estoni.

### **Dalin emailt/Djali i presidentit Biden drejton laboratorët e armëve biologjike në Ukrainë**

26/03/2022, 23:24



Nga ky hulumtim evidentohet se akuzat e sajura për programin e pretenduar të armëve biologjike kanë qarkulluar gjerësisht edhe në mediat në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Në total, hulumtuesit mundën të identifikonin 30 ripublikime të kësaj narrative në mediat lokale. Kjo histori është publikuar kryesisht nga portalet e lajmeve, të cilat kanë regjistruar 24 ripublikime.

Historia është përcjellë edhe nga faqet e internetit të

<sup>15</sup> Daily Mail, “EKSKLUZIVE: Hunter Biden ndihmoi në sigurimin e miliona dollarëve fonde për kontraktorin amerikan në Ukrainë të specializuar në kërkimin e patogjenëve vdekjeprurës; zbulohet nga emailt e laptopëve, duke ngritur më shumë pyetje rreth djalit të turpëruar të ish Zv. Presidentit.” (2022), <https://www.dailymail.co.uk/news/article-10652127/Hunter-Biden-helped-secure-millions-funding-military-biotech-research-program-Ukraine.html>, Aksesuar më 05.11.2022

tre televizioneve, dy gazetave dhe të një reviste. Pjesa dërmuese e ripublikimeve të lajmeve të rreme ka qarkulluar në Shqipëri (80 për qind), ku lajmet e rreme janë rishpërndarë 24 herë.

Të dhënat nga Crowdtangle tregojnë se kjo histori ka marrë gjithsej 927 ndërveprime në Facebook. Narrativat disinformuese me mesazhe pro-ruse për laboratorët e dyshuar të armëve biologjike në Ukrainë të financuar nga SHBA është shtyrë përmes dy historive të tjera. Njëra bazohet në një imazh, i cili gjoja tregon laboratorë sekretë të armëve biologjike të NATO-s në Fabrikën Metalurgjike Azovstal në Mariupol. Fabrika ishte skenë e luftimeve mjaft të ashpra mes forcave ruse dhe batalionit ukrainas Azov dhe u bë emblema e rrethimit të qytetit në mars 2022. Artikulli tjetër i lajmeve të rreme pretendon se Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-së dyshohet se ka pranuar ekzistencën e 46 laboratorëve të armëve biologjike në Ukrainë. Pretendimi erdhi nga një postim në Instagram dhe u riciklua nga media e sponsorizuar nga shteti rus. Ky artikull me lajme të rreme është përgënjeshtuar nga një organizatë e verifikimit të fakteve në Maqedoninë e Veriut (Vertemates.mk), fakt i cili u kap dhe botua nga disa portale lajmesh. Të dhënat e Crowdtangle tregojnë se artikujt që raportojnë se artikulli origjinal ishte i rremë regjistronin gjithsej 95 ndërveprime në Facebook, ose afërsisht një të dhjetën e ndërveprimeve të regjistruara për lajmin e rremë.

### 3.4 Të rremet përkundër të vërtetave: Lufta kundër narrativave disinformuese


Duke përcaktuar përhapjen të mesazheve pro-ruse dhe ukrainase në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes përhapjes së lajmeve të rreme, fotove dhe videove të nxjerra jashtë kontekstit, hulumtuesit ishin në gjendje të identifikonin gjithsej 41 artikuj me lajme të rreme dhe 38 përgënjeshtime të lajmeve të tilla. Gjithsesi, të dhënat nuk na ndihmojnë për të kuptuar audiencën. Edhe pse në Shqipëri mungojnë të dhënat për audiencën e mediave online, ndërveprimet në postimet në rrjetet sociale janë një tregues i mirë.

Të dhënat e marra nga Crowdtangle tregojnë se 41 artikuj me lajme të rreme dhe ripublikimet e

tyre të lidhura me pushtimin rus të Ukrainës u qarkulluan në 788 postime në mediat sociale, duke regjistruar gjithsej 190,384 ndërveprime në Facebook, me një mesatare prej 241 ndërveprimesh për një postim. Ndërsa 38 historitë që u përgënjeshtruan, bashkë me ripublikimet e tyre, u qarkulluan në 160 postime në mediat sociale dhe regjistruan gjithsej 7,906 ndërveprime, me një mesatare prej 49 ndërveprimesh për një postim. Shkalla mesatare e ndërveprimit për postim mes një artikulli me lajme të rreme ose me foto/video të nxjerra jashtë kontekstit, krahasuar me përgënjeshttrimin e botuar për të njëjtin artikull, sugjeron që disinformimi udhëton më shumë dhe më larg dhe krijon më shumë ndërveprime (komente, pëlqime, shpërndarje etj.) në Facebook.

Të dhënat e mbledhura përmes Crowdtangle mbi ripublikimet e lajmeve të rreme për të cilat kishte më shumë ndërveprime, sugjerojnë se fotot e nxjerra jashtë kontekstit ishin formati më efikas i disinformimit që përhapej në mediat standarde/sociale në Shqipëri në lidhje me pushtimin rus të Ukrainës. Në listën e dhjetë postimeve më interaktive me lajme të rreme, shtatë prej tyre janë foto të postuara në Facebook dhe tre janë adresa online me reportazhe të mediave online të shpërndara përmes mediave sociale. Nga dhjetë postimet më të njohura në mediat sociale, tre ishin publikuar në faqet publike në Facebook (një faqe zyrtare në Facebook e kryeministrit Edi Rama), tre nga faqet në Facebook të stacioneve televizive, tre nga media digjitale në vend dhe një nga faqja në Facebook e një gazete. Të dhjetë postimet më të njohura të mediave sociale përhapnin mesazhe në mbështetje të Ukrainës.

**Figura 6. Numri i ndërveprimeve për artikujt kryesorë me lajme të rreme**



## **RAST STUDIMOR: Kryeministri shqiptar shpërndan foto lufte të nxjerra jashtë kontekstit**

Përhapja e disinformimeve mund të jetë e qëllimshme ose si rezultat i ndonjë gabimi. Një mënyrë që disinformimi të bëjë xhiron e rrjetit është përmes raportimit qarkullues, që do të thotë se një burim publikon disinformimin, i cili merret dhe rishpërndahet nga një tjetër media apo faqe e mediave sociale, e cila citon burimin origjinal duke pretenduar kështu se informacioni është i saktë. Kur këtë lajm e ripublikojnë burime të tjera lajmesh, kështu cikli përrjetësohet.<sup>16</sup>

Dy nga pesë postimet më të njohura dhe me më shumë ndërveprime që u shpërndanë për pushtimin rus të Ukrainës në mediat standarde/sociale në gjuhën shqipe gjatë periudhës janar-gusht 2022 vijnë nga faqja në Facebook e Kryeministrit Edi Rama në formën e raportimit qarkullues. Të dy postimet ishin foto të nxjerra jashtë kontekstit, por me mesazhe pro-ukrainase. Për të dy postimet me përmbajtje të rreme të postuara në mediat sociale nga Edi Rama u regjistruan gjithsej 53,301 ndërveprime në Facebook, duke përbërë kështu rreth 28 për qind të totalit të ndërveprimeve të të gjitha lajmeve të rreme që lidhen me pushtimin rus të Ukrainës, të identifikuara nga BIRN përmes hulumtimit të tij. Postimi me më shumë ndërveprime nga Rama është një foto e dy fëmijëve që përshëndesnin ushtarë ukrainas. Fotoja është postuar nga kryeministri shqiptar më 27 shkurt 2022, tre ditë pas nisjes së pushtimit rus në Ukrainë, shoqëruar me një flamur ukrainas dhe emoji të një zemre të thyer. Sipas të dhënave nga Crowdtangle, vetëm ky postim regjistroi gjithsej 27,589 ndërveprime në faqen e rrjeteve sociale të Kryeministrit Rama. Problemi me foton e shpërndarë nga kryeministri shqiptar është se ajo nuk është bërë në ditët pas fillimit të pushtimit të Ukrainës nga Rusia, por shumë vite më parë. Fotoja është shkrepur nga fotografi ukrainas Dmytro Muravsky në mars të vitit 2016.

Postimi me angazhimin e dytë më të lartë ishte një tjetër foto e nxjerrë jashtë kontekstit e Miss Ukrainës,

---

<sup>16</sup> Biblioteka e Universitetit të Viktorias, "Lajmet e rreme", (2022), <https://libguides.uvic.ca/fakenews/how-it-preads>, Aksesuar më 19.12.2022.

Anastasiia Lenna, e veshur me uniformë ushtarake kamuflazhi, me një pushkë automatike, që sugjeronte se ajo i ishte bashkuar ushtrisë në mbrojtje të atdheut. Rama e postoi foton e Lennas më 1 mars 2022, me komentin “Deri dje ishte thjesht Miss Ukraina”, gjë që sugjeronte se Lenna tashmë ishte bërë ushtarë në mbrojtje të Ukrainës nga pushtimi rus. Fotoja e Lennas me uniformë ushtarake mori gjithsej 25,712 pëlqime e komente në Facebook. Gjithsesi, Lenna që prej asaj kohe ka sqaruar se nuk i është bashkuar ushtrisë dhe se fotoja kishte për qëllim vetëm të frymëzonte njerëzit. Të dy fotot janë shembuj disinformimi/propagande me mesazhe pro-ukrainase, të shpërndara përmes imazheve të nxjerra jashtë kontekstit që bien nën narrativën e “kostos së luftës në jetë njerëzish” dhe synojnë të nxisin emocione te ndjekësit e mediave sociale.

Rama ka një faqe me shtrirje të gjerë në rrjetet sociale me 1.61 milionë ndjekës. Sipas të dhënave të Crowdtangle, në 12 muajt e fundit faqja kishte gjithsej 17.3 milionë ndërveprime dhe 124.82 milionë shikime video, 55.5 për qind e të cilave ishin në postime e transmetime live. Seksioni i videove në faqen e Kryeministrit quhet Edi Rama Televizion ose ERTV dhe, pavarësisht se nuk është një llogari zyrtare e qeverisë, përdoret si një instrumenti kryesor i komunikimit digjital nga zyra e qeverisë. Përmbajtja e llogarisë, përfshirë këtu videot, postimet dhe njoftimet live, prodhohen nga departamenti i komunikimit i qeverisë. Gjithsesi, siç doli në pah edhe nga ky hulumtim, edhe burime të tillë të mediave sociale të financuar nga shteti nuk janë imune ndaj përhapjes së disinformimeve. Rreziku është shumë më i madh për ata individë në mediat sociale, të cilët nuk kanë burimet dhe trajnimin e duhur profesional për të verifikuar vërtetësinë e informacionit të postimeve.

### 3.5 Angazhimi me lajmet e rreme

Ashtu si edhe në rastin studimor, artikujt me lajme të rreme marrin përhapje, sepse individët dhe strukturat editoriale nuk i kushtojnë kohën e duhur verifikimit të vërtetësisë së lajmeve. Ka raste kur lajmet e rreme shpërndahen dhe ripostohen nga individë, sepse këta të fundit janë të bombarduar me to ose për faktin se ndonjëherë disinformimi është më interesant dhe ngjall emocione më të forta

te lexuesit apo ndjekësit.


Nëpërmjet të dhënave të analizuara me ndihmën e tabelave pivot në Excel, hulumtuesit e këtij studimi mundën të identifikonin jo vetëm numrin e artikujve me lajme të rreme, fotove e videove të nxjerra jashtë kontekstit në mediat në gjuhën shqipe, por edhe numrin e angazhimeve/ndërveprimeve në total të regjistruara nga lajme të tilla të rreme në mediat sociale. Të dhënat nga Crowdtangle tregojnë se mediat me qendër në Shqipëri qarkulluan 38 artikuj me lajme të rreme, të cilat regjistruan 125,778 ndërveprime në Facebook. Mediat në gjuhën shqipe me qendër në Maqedoninë e Veriut qarkulluan 16 lajme të rreme, të cilat morën në total 7,062 ndërveprime në Facebook, dhe mediat me qendër në Kosovë regjistruan 53,113 ndërveprime në Facebook për 22 artikuj me lajme të rreme. Postimet në mediat sociale në gjuhën shqipe nga portalet e lajmeve me qendër në vende të tjera kanë regjistruar gjithsej 4,431 angazhime në Facebook.

Postimet nga portalet digjitale shqiptare të lajmeve në të tre vendet publikuan 73 për qind të totalit të artikujve të identifikuar. Në mediat sociale këto lajme përbënin 38 për qind të ndërveprimeve. Megjithëse faqet në Facebook publikuan 11 për qind të lajmeve të rreme, niveli i angazhimit të tyre ishte 42 për qind e totalit, e ndjekur nga televizionet me 14 për qind dhe kanalet e mediave sociale të gazetave me 4 për qind të totalit të angazhimit.

Sipas të dhënave të Crowdtangle, mesatarisht një postim me lajme të rreme nga një faqe në Facebook - jo kanal i mediave sociale të mediave digjitale apo ato standarde - ose një foto e nxjerrë jashtë kontekstit ka marrë 951 ndërveprime, por nëse do të postohej në kanalën e mediave sociale të një portali lajmesh, do të regjistronte 126 ndërveprime. Gazetat kishin mesatarisht 385 ndërveprime dhe stacionet televizive 215. Të dhënat sugjerojnë se faqet e njohura në Facebook nga personalitete publike mund të jenë në kushte të caktuara më efikase se edhe vetë kanalet e mediave sociale të mediave kryesore për sa i përket angazhimit të audiencës me lajme të rreme ose foto dhe video të nxjerra jashtë kontekstit.

**Figura 7. Përqindja në total e angazhimit sipas llojit të medias**

**PËRQINDJA NË TOTAL E ANGAZHIMIT SIPAS LLOJIT TË MEDIAS**





## IV. Përfundime dhe rekomandime

---

Të dhënat e mbledhura nga hulumtuesit sugjerojnë se mediat digjitale online, shpesh të njohura në vend edhe si portale lajmesh, ishin më të prirura të publikonin lajme të rreme për pushtimin rus të Ukrainës. Këtyre mediave shpesh u mungojnë burimet për të krijuar struktura efikase editoriale dhe për të trajtuar përmbajtjet që merren copy-paste nga media të tjera pa verifikuar më parë vërtetësinë e fakteve, fotove ose videove të këtyre lajmeve.

Përhapja e lajmeve të rreme për pushtimin rus të Ukrainës në mediat në gjuhën shqipe nuk ka një sfond të qartë ideologjik, por mund të lidhet me paaftësinë e mediave në vend për të filtruar disinformimin për shkak të dobësisë së strukturave editoriale.

Ndonëse Shqipëria e mbështet luftën e Ukrainës kundër pushtimit rus, përhapja e lajmeve të rreme në mediat lokale - edhe pse shumica janë me mesazhe pro-ukrainase - nuk përbën zhvillim pozitiv, sepse tregon se ka mungesë aftësish/kapacitetesh për të luftuar fushatat disinformuese.

Me zhvillimin e vazhdueshëm të konflikti në Ukrainë po zhvillohen edhe fushatat e disinformimit, të cilat përhapen edhe në nivel botëror. Është e nevojshme që gazetarët, mediat dhe verifikuesit e fakteve të monitorojnë vazhdimisht vërtetësinë e informacionit që vjen nga zona e luftës dhe të trajtojnë me seriozitet përhapjen e lajmeve të rreme. Edhe pse një vend ose një media e caktuar mund të mos jetë objektiv i disinformimit, ato mund të bien pre e lajmeve të rreme po aq lehtë, pasi lajme të tilla nxiten nga faktorë komercialë dhe jo ideologjikë.

Duke qenë se lajmet e rreme kanë fuqinë të ecin me shpejtësi dhe të shkojnë shumë larg, mediat në Shqipëri duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të forcojnë strukturat editoriale dhe kapacitetet për verifikimin e fakteve.

Siç sugjerohet nga të dhënat e këtij studimi, përdoruesit e mediave sociale ndërveprojnë më shumë me lajmet e rreme dhe keqinformimet dhe kanë një nivel më të ulët ndërveprimi me artikujt që i përgënjeshtrojnë këto lajme, duke theksuar kështu nevojën për të filtruar dhe ndaluar përhapjen e lajmeve të rreme dhe disinformimit përpara publikimit si dhe ndalimin e rrethit vicioz.

Edhe pse është me rëndësi monitorimi dhe përgënjeshtrimi i lajmeve të rreme nga organizatat e verifikimit të fakteve, ato nuk mund të zëvendësojnë apo përmbushin nevojën që lidhet me forcimin e strukturave editoriale dhe të aftësive për verifikimin e fakteve te vetë mediat me qëllim ndalimin e përhapjes së disinformimit.



LAJMET E RREME MBI  
**PUSHTIMIN RUS TË UKRAINËS**  
NË MEDIAT SHQIPFOLËSE



© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (Balkan  
Investigative Reporting Network in Albania - BIRN)  
Tiranë, 2023